

Roli i Kuvendit në qasjen e re për negociata ndaj BE

Në fillim të shkurtit të vitit 2020, Komisioni Evropian i kumtoi skicën e propozimit të metodologjisë së re për negociata me vendet e Ballkanit Perëndimor. Metodologjia është rezultat i nevojës për të ekzistuar proces i cili do të sigurojë se anëtarët e ardhshme nuk do të jenë vende me probleme të rëndësishme në menaxhimin demokratik dhe sundimin e të drejtës.

Në procesin e negociatave është grupimi i kapitujve për të cilat bëhen negociata. Kapitujt janë të grupuara në kalaveshë (klasterë) nga të cilët, për fillim, më i rëndësishmi është ai ku gjendet pengimi i korrupsionit, sundimi i të drejtës, furnizime publike, siguri, reformë e administratës publike dhe kontrolli financiar. Grupimi është bërë që problemet të zgjidhen në mënyrë horizontale, përmes intervenimeve në më tepër sektorë. Ajo e rrit kompleksitetin e reformave, por në të njëjtën kohë, nëse bëhet mirë, siguron edhe qëndrueshmëri të ndryshimeve.

Ku është këtu roli i Kuvendit?

Në projektin e skicimit të metodologjisë së re negociatore, parlamentet asnjë herë nuk përmenden. Prapëseprapë, t njëjtën ditë kur u prezantua metodologjia, komisarja për zgjerim Varheli theksoi se parlamentet e Ballkanit i sheh si link të rëndësishëm me qytetarët. Parlamenti Evropian, gjithashtu, tanimë një kohë të caktuar e thekson rolin mbikëqyrës të parlamenteve si të nevojshme në procesin e negociatave.

Nga kjo, pritja e parë vjen nga qytetarët, për përfshirje aktive të deputetëve në procesin, ndërsa nga ana tjetër, këtu është shprehur pritja e Unionit Evropian, i cili në parlamentet sheh një rol të rëndësishëm mbikëqyrës.

Këto pritje e theksojnë rolin e dyfishtë të Kuvendit. Pa marrë parasysh se Qeveria do të udhëheq negociatat, deputetët kanë rol të theksuar në krijimin e politikave të cilat do ta zbatojnë procesin e përafritimit ndaj UE. Ajo ë paraprakisht është e njohur është se procesi do të zgjasë më tepër se 10 vite, kështu që Kuvendi është një vend i përkryer për ta siguruar qëndrueshmërinë e ndryshimeve dhe të prioritetëve pa dallim se cilat parti janë në shumicë. Problemet që duhet të zgjidhen janë të mëdha dhe do të përfshijnë ndryshime të konsiderueshme në institucionet. Nga kjo, përmes negociatave në parlamentin, nevojiten negociata të vazhdueshme për shkak të sigurimit të konsensusit. Në sigurimin e këtij konsensusi, nevojitet edhe përfshirja e shoqërisë civile në forumin kuvendor, gjatë diskutimeve se di të formulohen politikat dhe si të përcaktohen prioritetet.

Nga ana tjetër, roli mbikëqyrës i Kuvendit duhet të sigurojë edhe përmbushje të detyrave. Në atë kuptim, roli i deputetëve është që të sigurohen se ndryshimet nuk bëhen vetëm për përafritim ndaj BE, por reformat sjellin edhe rezultate të dukshme për qytetarët. Vetëm në këtë mënyrë, forumi kuvendor të harmonizimit të ndërsjellë midis palëve të ndryshme në politikën, do të kuptohet si proces legjitim në interes të qytetarëve.

Projekti "Bisedë për luftë kundër korrupsionit në Kuvendin" (Anti – Corruption Talkin Parliament (ACT in Parliament)) përfshin edhe aktivitete përfaqësuese hulumtuese me qëllim parësor të përkrahje të procesit reformues në Maqedoninë e Veriut përmes përforsimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit, në raport me luftën kundër korrupsionit.

Projekti është i përkrahur nga Fondi ndërkombëtar për demokraci (National Endowment for Democracy – NED) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për përmbajtjen përgjegjës është IDSCS dhe në asnjë rast nuk i pasqyron pozitat e Fondit ndërkombëtar për demokraci (National Endowment for Democracy - NED).